



**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI**  
**në mes të**  
**KONFEDERATËS SINDIKALE HAK-İŞ (HAK-İŞ)**  
**dhe**  
**BASHKIMIT TË SINDIKATAVE TË PAVARURA TË KOSOVËS (BSPK)**

Ankara, Turqi, 22 tetor 2012

Lidhet Marrëveshja e Bashkëpunimit në mes të Konfederatës Sindikale HAK-İŞ nga Republika e Turqisë (e cila referohet si HAK-İŞ) dhe Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës (e cila referohet si BSPK) nga Republika e Kosovës.

Konfederata Sindikale HAK-IS dhe Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK) kanë arritur marrëveshje bilaterale, marrëdhënie miqësore duke u bazuar në sindikalizëm të pavarur, të drejta sindikale dhe drejtësi sociale. Themelimi i benefiteve reciproke të termit afatgjatë dhe reciprocitetit bëhet duke marrë në konsideratë marrëdhëniet e punës dhe promovimin e bashkëpunimeve ndërkombetare. Ndryshime pozitive në marrëdhëniet regjionale dhe ndërkombetare, ndryshimet drastike në ekonominë botërore janë edhe objektiva kryesore të kësaj marrëveshjeje.

Duke marrë në konsideratë kushtet ekonomike dhe sociale si dhe zhvillimet e tanishme në të dy shtetet, HAK-İŞ dhe BSPK (tani e tutje referohen si "PALET") kanë për qëllim të zhvillojnë relacione bilaterale, të shkëmbejnë informata dhe eksperiencën në mes të dy konfederatave. Të dy palët u pajtuan që:

1. Të shkëmbejnë delegacione në mes vete në mënyrë që të mësojnë nga përvojat e tyre për jetën sindikale dhe aktivitetet sindikale të të dyja shteteve.
2. Të kenë si qëllim ndihmën ndaj anëtarëve sindikal dhe organizatave të të dyja shteteve në mënyrë që të krijohet një relacion reciprok i cili sjell benefite për të dyja palët.
3. Të ketë më shumë kujdes në informim, të shkëmbehet literaturë, gazeta sindikale, buletine dhe materiale tjera të marrëdhënies së punës dhe aktiviteteve sindikale.
4. Të ofrohen shërbime konsultative si dhe trajnime të anëtarëve sindikal dhe trajnime të ekspertëve në mes të dy Konfederatave,
5. Të shkëmbehen programet trajnuese për trajnim të anëtarëve dhe ofrimin e ekspertëve trajnues dhe pjesëmarrje në programe të tilla.
6. Të informojmë njëri tjetrin për zhvillimet aktuale në politikën sociale siq janë; sigurimet sociale të dy shteteve.

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hyn në fuqi pasi të nënshkruhet nga të dyja palët. Kjo Marrëveshje mund të anulohet nëse njëra nga palët shpreh dëshirë për mosbashkëpunim të mëtutjeshëm. Pala tjetër duhet të njoftohet jo më larg se tre muaj më parë në rast të anulimit të marrëveshjes.

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi u shkrua në të dy gjuhët në gjuhën Angleze dhe atë Truke dhe pala e BSPK mund të përkthejë edhe në versionin e gjuhës shqipe nëse dëshiron. Gjitha versionet e përkthimit të kësaj Marrëveshjeje do të kenë të njëjtën fuqi.

**Mr. Mahmut ARSLAN**  
**President**  
HAK-İŞ Konfederata

**Mr. Haxhi ARIFI**  
**President**  
Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK)